



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:909274
Datë: 08.02.2024
Numri i dokumentit: 05305059

C.nr.1340/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, dhe me bashkëpunëtoren profesionale Ardiana Nikollbibaj duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses XH.K., , e vajzërisënga Gjakova, rruga "...", numër 39, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avdi Rizvanolli, avokat në Gjakovë, kundër të paditurave B.E., SH.A me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit me nr.1707 të datës 08.11.2021, e përfaqëson F.G., zyrtare ligjore në kompaninë DLR në Prishtinë, E.K., , E.K., , e vajzërisë nga Gjakova, rruga "...", numër., V.k., dhe V.K., që të gjithë nga Gjakova rruga "...", numër 39, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Teki Bokshi avokat në Gjakovë, me objekt kontesti vërtetim pronësie në bazë të kontributit martesor, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik, në të cilin morën pjesë paditësja me të autorizuarin e saj, përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës së parë dhe përfaqësuesi i autorizuar i të paditurve 2,3,4 dhe 5, me 08 shkurt 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditëses XH.K., nga Gjakova, kundër të paditurave B.E., SH.A me seli në Prishtinë dhe E.K., , E.K., e vajzërisë K..V.K., dhe V.K., ë të gjithë nga Gjakova, me të cilën kanë kërkuar që të: VËRTETOHET se paditësja XH.K., i, e lindur .. nga Gjakova është pronare sipas bazës së kontributit martesor e ½ pjesë ideale e paluajtshmërisë e cila evidentohet si njësi kadastrale P-70705029-05071-32 me kulturë shtëpi, në sipërfaqe të përgjithshme 207 m²ZK Gjakovë-qytet, për çka të paditurit B.E., SH.A. Prishtinë, E.k., e lindur ... V.K., , V.K., dhe E.K., nga Gjakova që të gjithë nga Gjakova, DETYROHEN që të ia njohin këtë të drejtë. II. VËRTETOHET se marrëveshja hipotekare e lidhur në mes të paditurës B.E., SH.A. Prishtinë dhe ish NTSH "...” Gjakovë, me pronar të paditurin V,K, nga

Gjakova dhe tani të ndjerin I.K., ish nga Gjakova, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë nën Vr.nr.152/2016 të datës 12.01.2016, është e pa efekt juridik ndaj paditëses XH.K., nga Gjakova, në pjesën sa i përket $\frac{1}{2}$ pjesë ideale të paluajtshmërisë e cila evidentohet si njësi kadastrale P-70705029-05071-32 me kulturë shtëpi, në sipërfaqe prej 76 m² dhe me kulturë oborr, në sipërfaqe prej 131 m², përkatësisht në sipërfaqe të përgjithshme 207 m² ZK Gjakovë – qytet, për çka të paditurit B.E., në Prishtinë dhe V.K., DETYROHEN që pranojnë këtë, dhe kreu këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

II. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditëses, sa i përket kërkesës për shpalljen pjesërisht të palejuar të përmbarrimit E.nr.1072/10, dhe E.nr.1074/10, i lejuar nga Gjykata Komunale në Gjakovë.

III. Secila palë bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja fillimisht në padinë e dorëzuar në këtë gjykatë me 10.01.2013, ka parashtruar se është pronare e $\frac{1}{2}$ pjesë ideale të ngastrës kadastrale nr.5071/32 me kulturë shtëpi dhe oborr në sipërfaqe të gjithmbarshme prej 0.02.07 ha, Zona Kadastrale Gjakovë- qytet sipas Certifikatës mbi të drejtën e pronës UL-70705029-01688. Ka parashtruar se e paditura e parë dhe e tretë kanë lidhur dy kontrata mbi kredinë- marrëveshjen kreditore nr.1555/2/Gja dhe 1556/2/Gja të datës 06.10.2010 dhe kanë lidhur marrëveshjen hipotekare nr.1555/3/Gja të datës 06.10.2010 e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë VR.nr.148/2010 e datës 12.01.2010 dhe V.nr.152/2010 e datës 12.01.2010 duke iu lënë të paditurës së parë si hipotekë pasurinë e paluajtshme e cila evidentohet në emër të ish të paditurit të dytë - tani të ndjerit I.K., sipas Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-670705029-01688 të datës 06.01.2010, meqenëse paditësja e trajton vetveten si bashkëpronare në $\frac{1}{2}$ pjesë ideale të paluajtshmërisë së lartcekur, duke konsideruar se bartja e kësaj prone- vënia e hipotekës në interes të sigurimit të kredisë për të paditurën e parë nuk ka efekt juridik ndaj paditëses sa i përket në $\frac{1}{2}$ pjesë ideale të saj nga se ajo pjesë prej $\frac{1}{2}$ është pronë ekskluzive e paditëses, duke u mbështetur në nenin 50 të Ligjit për familjen ku është paraparë e drejta e bashkëshortit tjetër kur vetëm njëri nga bashkëshortët regjistrohët si bartës i të drejtës pronësore në regjistrin e të drejtave në pasurinë e

patundshme, konsiderohet se regjistrimi është bërë edhe në emër të bashkëshortit tjetër, ku konsideron se deklaratat e njëanshme hipotekare me të cilat nuk mund të disponojnë të paditurit dhe nuk mund të ketë efekt juridik në raport me paluajtshmerinë e lartcekur që është pronë e paditëses, andaj mbi këtë bazë dhe në kuptim të nenit 61.5 të Ligjit për procedurën përmbartimore ka kërkuar që përmbartimi sipas aktvendimeve Ekz.nr.1072/10 dhe Ekz.nr.1074/10 të shpallën të palejueshme.

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbesim në tërësi pranë pretendimeve të theksuara në padi, parashtresat e palës paditëse si dhe të deklaratave gjatë shqyrtimeve në seancat paraprake, duke propozuar që padia dhe kërkesëpadija e paditëses të aprovohet në tërësi si e themeltë. Paditësja me bashkëshortin e saj ka jetuar 50 vite pa ndërprerë pasi që e njëjta ka lidhur kurorë me ish bashkëshortin e saj në vitin 1963 i cili ka vdekur në vitin 2013 gjatë kësaj bashkësie martesore kanë lindur 4 fëmijë të përbashkët. Po ashtu theksoj se gjatë bashkësisë martesore paditësja ka qenë në marrëdhënie të punës si mësimdhënëse nga 01.09.1963 e deri 31.08.1982 dhe gjithsej ka punuar 18 vite e 11 muaj e 30 ditë në punë të mësimdhënësës në shkollën fillore “...” në Gjakovë ku gjykatës si provë ia dorëzoi vërtetimin e datës 19.10.2021, duke sqaruar se paditësja fare nuk ka qenë e njoftuar dhe as që është ftuar nga këtu e paditura e parë si për kontratën mbi kredinë ashtu edhe për kushtet dhe pasojat e arritura në mes bashkëshortit të saj si kredi marrës dhe të paditurit të parë si kredi dhënës. Këtu për herë të parë paditësja u njoftua pasi që i padituri i parë me të iniciuar procedurën përmbartimore ka kërkuar që të përmbushet kredia e marrë nga këtu bashkëshorti i saj për shitjen e paluajtshmërisë së lënë hipotekë, fare pa qenë e njoftuar paraprakisht për veprimet e ndërmarra nga i paditur i parë dhe bashkëshorti i saj për çka edhe ka iniciuar procedurë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë me ½ pjesë ideale të paluajtshmërisë e cila i takon në bazë të ligjit në bazë të kontributit të saj martesor. Po ashtu ka shtuar se sa i përket pretendimeve të aut. të paditurës së parë, këto pretendime duhet të vlerësohen si të pa mbështetura pasi që nuk është vërtetuar se paditësja ka qenë në dijeni për ngarkimin e paluajtshmërisë me hipotekë apo nga e njëjta të jetë kërkuar dhënia e pëlqimit e që në rast të mos përgjegjësisë së paditëses në atë situatë mund të konsiderohet se paditësja me heshtjen e saj ka dhënë pëlqim, për lidhjen e kontratës dhe respektivisht garantimin e kredisë kushtet e kredisë dhe pasojat e mos përmbushjes së detyrimit nga marrëveshja e arritur në mes kredi dhënësit dhe kredi marrësit. Në riprocedurë gjykata ka vepruar tërësisht sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit, ku është rekomanduar të vërtetohet fakti se a ishte fituar patundshmëria lëndore më punë gjatë vazhimit të martesës apo ishte pasuri e veçantë e I.K., është vërtetuar me prova materiale

të sigurta dhe të qarta se prona që është objekt kontesti është blerë në vitin 1968, trualli – toka ndërtimore është fituar me vendimin komunal me nr.93-6606/1968 të datës 19.09.1968, ngastra 5071/12 në sipërfaqe prej 414 m², paditësja me bashkëshortin e saj të ndjerë e kanë ndërtuar shtëpinë në truallin ndërtimore që ju ka takuar sipas kontratës për ndarjen e bashkësisë familjare të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë me nr. Vr.nr.1323/81 të datës 15.12.1981, nga shkresat e lëndës konstatohet se martesë në mes të paditëses dhe bashkëshortit të saj të ndjerë është lidhur me 14 shkurt 1963 dhe në këtë martesë kanë lindur 4 fëmijë- këtu të paditurit, e njëjta përveç punëve të zonjës së shtëpisë, kujdesin për bashkëshortin dhe fëmijët ka ekonomizuar, ka qenë mësuese e punësuar që nga data 01.09.1963 deri me 31.08.1982, fakte këto të pa kontestueshme. Andaj nga provat e administruara është vërtetuar plotësisht gjendja faktike se paditësja është pronare e pronës së përbashkët në proporcion më të lartë se ½ pjesë ideale ngase kontributi i paditëses ka qenë më i madh se i të ndjerit I....gjykatës i ka propozuar që të e aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: në emër të taksës në padi shumën prej 40,00 euro, në emër të seancave gjyqësore shumën prej 3,375.00 euro (270.00 x 5), në emër për përpilimin e parashtresës së palës paditëse shumën prej 208.00 euro, në shumë të përgjithshme prej 3.623,00 euro.

E paditura e parë, përmes të autorizuarës së saj përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka parashtruar se e kundërshtojnë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, ngelen në tërësi pranë përgjigjes në padi. Biznesi N.T.SH ...” i përf. nga V.K., i padituri i dytë I.K., ish bashkëshorti i paditëses kanë lidhur disa herë marrëveshje për kredinë në B.e.,dhe të njëjtit kanë përfituar nga kreditë e shfrytëzuara siç shihet edhe në certifikatën e fletëposedimit me nr. UL-70705029-01688 të datës 06.01.2010 i bashkëngjitur në përgjigje në padi, e njëjta pronë ka qenë disa herë e lënë hipotekë tek banka mirëpo asnjëherë paditësja nuk ka ndërmarr asnjë veprim për të kërkuar të drejtën e saj për vërtetimin e pronësisë, tek kur është iniciuar rasti në procedurë përmbarimore për shkak të mos pagesës së borxhit e njëjta ka kërkuar përmes padisë të drejtën e saj e cila ka kërkuar vetëm zvarritjen dhe prolongimin e procedurës përmbarimore, andaj pas administrimit të provave dhe fakteve të bashkëngjitura në lëndë kërkon nga gjykata që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses në tërësi. Tutje ka theksuar se paditësja nuk ka paraqitur asnjë provë ose fakt konkret me të cilin do të mbështeste pretendimet e veta, ashtu siç shihet nga dokumenti zyrtar i lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë, I...K.. parcelën me numër 5071/31 në vitin 1981 në bazë të kontratës së ndarjes leg.nr.1323/81 e datës 15.12.1981 prej Sh... K...e lindur K..e veja M., prona kalon në posedim të I.K., andaj edhe sipas

Ligjit për Familjen Ligji Nr.2004/32 neni 46 paragrafi 2 si Pasuri e veçantë e bashkëshortëve është gjithashtu edhe pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së martesës përmes trashëgimisë, dhurimit apo ndonjë forme tjetër ligjore të fitimit të pasurisë. Andaj, bazuar nga të lartcekurat gjykatës i kërkojmë që të e refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses XH.K., për vërtetim pronësie pasi sipas Ligjit për Familje parcela me numër 5071/31 konsiderohet pasuri e veçantë e I.K., dhe XH.K., nuk mund të kërkojë të drejtën mbi 1/2 e saj.

Të paditurit 2, 3, 4 dhe 5, përmes të autorizuarit të tyre përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare kanë parashtruar se mbeten në tërësi pranë pretendimeve nga shqyrtimet e kaluara dhe në parashtrësa, gjykatës i propozon që të nxjerr provat të cilat janë deponuar në shkresat e lëndës. Në kuptim të sugjerimeve të gjykatës ankimore dhe argumentimit të pretendimeve së palës së paditur se paluajtshmeria është pronë e përbashkët e tash të ndjerit I. dhe bashkëshortes së tij, në kuptim të nenit 47 të Ligjit mbi Familjen. Përndryshe sa i përket pretendimeve të paditurës së parë konsideron se parashtrimet e saj janë të pabazuara ngase Banka me rastin e kontraktimit detyrimisht është dashur që të trajtoj si palë kontraktuese edhe bashkëshorten e tani të ndjerit Iljaz ngase pavarësisht prej faktit ka qenë apo jo paluajtshmeria lëndore e evidentuar edhe në emër të saj sipas Ligjit ajo trajtohet bashkëpronare kështu konsideroj se kërkesëpadia e palës paditëse është e bazuar dhe të njëjtën të paditurit 2-5 e pranojnë në tërësi si të bazuar. Në konteste të kësaj natyre dy momente janë kyçe fundamentale: 1) Kur është vendos raporti bashkëshortor dhe 2) Kur është fituar pasuria, në këtë rast qartësisht është vërtetuar se bashkësia martesore e paditëses dhe bashkëshortit të saj të ndjerë I...është vendos gati një deçenie më parë dhe paditësja ka ekonomizuar si mësuese është kujdesur për familje, ka lindur dhe është kujdesur për familjen, madje në këtë çështje këtu të paditurit V..., E..., E.. dhe V.K., do të duhej të ishin paditës. Gjykata e Apelit e Kosovës ka sugjeruar që të vërtetohet fakti se prona lëndore a është pronë e përbashkët e bashkëshorteve apo ka qenë pronë e veçantë, ku në riprocedurë pa asnjë mëdyshje ky fakt është vërtetuar.

Për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje juridike, gjykata në procedurën e provave duke u kujdesur për zbatimin e sugjerimeve të gjykatës së shkallës së dytë, si dhe duke vepruar sipas propozimit të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat e nxjerra në procesverbalin e datës 26.01.2017, dhe atë: certifikatën e vdekjes me numër rendor 419 e lëshuar me datë 13.12.2016 në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë; ekstraktin nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. ser. E21164709 e lëshuar me datë 14.12.2016 në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë; ekstraktin nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. ser. E21164696 e lëshuar

me datë 14.12.2016 në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë; ekstraktin nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. ser. E21164712 e lëshuar me datë 14.12.2016 në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë; ekstraktin nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. ser. E21164702 e lëshuar me datë 14.12.2016 në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë; certifikatën e martesës me numër të certifikatës GJA 834, me numër rendor 28/1963 e lëshuar me datë 18.03.2008 në zyrën e gjendjes Civile në Gjakovë; deklaratën për bashkësi familjare me numër rendor 2/2001/1 e lëshuar me datë 13.12.2016 në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë; marrëveshjen hipotekare nr. 1555/3/GJA e datës 06.01.2010; aktvendimin për regjistrimin e hipotekës me numër të protokollit 4/10 të datës 13.01.2010; aktvendimin E.nr.1072/10 i datës 08.07.2011 i Gjykatës Komunale në Gjakovë; aktvendimin Ac.nr.523/12 të datës 19.11.2012 i Gjykatës së Qarkut në Pejë; shkresat e lëndës V.nr.152/2010 të datës 12.01.2010; vërtetimin e lëshuar nga shkollanë Gjakovë të datës 19.10.2021 si dhe Historiatin për ngastrën kadastrale 5071/32 ZK Gjakovë-qytet.

Gjykata pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku në kuptim të dispozitave të nenit 8 të LPK-së ka ardh në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e pabazuar për arsyet si në vijim:

Në këtë rast nuk ishte kontestues fakti se në mes të paditurë se parë dhe paraardhësit të te paditëses dhe të paditurve 2, 3, 4 dhe 5 është lidhur kontrata për hipotekën, e që objekt i hipotekës ka qenë prona e paluajtshme e evidentuar nr.5071/32 me kulturë shtëpi dhe oborr, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0-02-07 ha.

Po ashtu nuk ishte kontestuese se e paditura e parë ka iniciuar procedurën përmbarimore, e me këtë rast prona objekt i kontratës se hipotekës me numër nr.1555/3/GJA e datës 06.01.2010, pas përfundimit të procedurave të përmbarimit, është bartur në emër të te paditurës se parë.

Tutje, nuk ka qenë kontestues fakti se paditësja ka qenë e martuar me tani të ndjerin I.K., fakt ky i vërtetuar nga certifikata e martesës me numër rendor 28/1963, sikurse që nuk ishte kontestues fakti se paditësja është nëna e të paditurve V., E...E... dhe V.. që të gjithë K...fakt i vërtetuar përmes ekstrakteve të lindjes për të paditurit në fjalë të dorëzuara në gjykatë.

Kontestues nuk ishte as fakti se tani i ndjeri I... ish bashkëshorti i paditëses, ka figuruar si pronar i vetëm i paluajtshmërisë lëndore që evidentohet sipas certifikatës së pronës UL-70705029-

01688, parcela kadastrale nr.5071/32, me kulturë shtëpi dhe oborr, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0-02-07 ha në kohën e nënshkrimit të marrëveshjes hipotekare me të paditurën e parë.

Kontestuese në këtë rast ishte çështja e të drejtës së pronësisë së paditëses me 1/2 të paluajtshmërisë e cila evidentohet me numër nr.5071/32 me kulturë shtëpi dhe oborr, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0-02-07 ha, për të cilën pretendohet se është fituar me kontribut martesor.

Në këtë rast, edhe pse nuk ishte kontestuese, nga marrëveshja hipotekare nr.1555/3/GJA e datës 06.01.2010, u vërtetua se këtu e paditura e parë me N.T.SH “...” si Biznes Individual e përfaqësuar nga V.K., - i padituri i katërt dhe tani i ndjeri I.K., (bashkëhuamarrësi), në cilësinë e bashkëshortit të paditëses si garanci për kredinë e marrë në vlerën prej 41,674.00 € dhe mbi tërheqjen e lejuar në vlerën prej 50,000.00 €, kanë garantuar pasurinë e paluajtshme - përkatësisht paluajtshmerinë lëndore sipas Fp.nr.UL-70705029-0688, parcela kadastrale nr.5071/32 me kulturë shtëpi dhe oborr, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0-02-07 ha, e cila pasuri hipotekare është vlerësuar në shumën prej 85,950.00 €. Tutje në këtë kontratë, përkatësisht në nenin 4 të saj është theksuar se pronar i pasurisë hipotekare në cilësinë e huamarrësit, bashkë huamarrësit dhe garantuesit është pronë e tyre dhe nuk është kontestuese është e lirë prej çfarëdo pretendimi nga palët e treta, në mënyrë legale (padi) ose ndryshe, se nuk guxon të ia jep personit tjetër në hipotekë, të hyn dorëzanë, të ndërmjetëson ose të shes pjesë të saj dhe nuk guxon të ndërmerr asgjë që e zvogëlon vlerën e paluajtshmërisë së lënë në hipotekë me çfarëdo veprimi të natyrës juridike apo fizike.

Tutje, me aktvendimin për regjistrimin e hipotekës me numër të protokollit 4/10 të datës 13.01.2010, të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës- Zyra Komunale e Kadastrit në Gjakovë, u vërtetua se është lejuar regjistrimi i hipotekës në regjistrin e të drejtave të pronave të paluajtshme të identifikuar në Certifikatën UL-70705029-01688 ZK Gjakovë-qytet, e evidencuar në emër të I.K., nga Gjakovë për kredinë në shumën prej 41,674.00 € dhe mbi tërheqjen në shumën prej 50,000.00 € me afat kthimi 12 muaj, prioriteti i tretë.

Nga shkresat e lëndës V.nr.152/2010 të datës 12.01.2010, të administruara në këtë shqyrtim vërtetohet fakti se me datë 12.01.2010, në Gjykatën Komunale në Gjakovë është legalizuar marrëveshja hipotekare mbi pasurinë e paluajtshme e lidhur me datë 06.01.2010, me nr.1555/3/Gja, në Gjakovë në mes të huadhënësit B.E., të cilën e përfaqëson V.LL., dhe huamarrësit

N.T.SH. “...” nga Gjakova, të cilën e përfaqëson V.K., si dhe bashkëhuamarrësi I.M., , i cili e lenë si hipotekë të rendit të tretë paluajtshmërinë e evidentuar në fletën e posedimit nr. UL-70705029-01688, ngastra kadastrale nr.5071/32 me kulturë: shtëpi dhe oborr, në sipërfaqe të përgjithshme 0-02-07 ha, zona kadastrale Gjakovë-qytet.

Nga vërtetimi i lëshuar nga shkolla, në Gjakovë të datës 19.10.2021, vërtetohet se paditësja XH.K., , e lindur me datë 10.10.1941 ka filluar punë në pozitën e mësimit në mesimdhënës me datë 01.09.1963 dhe ka punuar deri me datë 31.08.1982, gjithsejtë ka 18 vite, 11 muaj dhe 30 ditë përvojë pune në shkollën “....” në Gjakovë.

Nga historiatu kadastral i siguruar nga ana e kësaj gjykate për ngastrën 5071/32 ZK Gjakovë-qytet, konstatohet se në vitin 1971, në bazë të vendimit nr.03-6606/1968 të datës 19.09.1968, parcela nr.5071/32, ZK. Gjakovë- qytet, me kulturë truall në sipërfaqe prej 0.04.14 ha, sipas fletëposedimit nr.1688 evidentohet në posedim të Sh.. K..e lindur .., e veja e M.. nga Gjakova. Në vitin 1981 parcela nr.5071/32 pëson ndarje dhe formohen këto parcela të reja: Parcela nr.5071/32, me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 0.00.76 ha, oborr në sipërfaqe prej 0.01.31ha, Parcela nr.5071/46, kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 0.01.01ha, oborr në sipërfaqe prej 0.01.06ha, të cilat mbesin në posed të Sh.. K.. e lindur K, e veja M..t nga Gjakova. Ndërsa në vitin 1981 në bazë të kontratës së ndarjes, leg. Nr. 1323/81, të datës 15.12.1981, parcela nr.5071/32, prej: . K.. e lindur ..e veja M.. kalon në posed të I.K.,, parcela nr.5071/46 prej: S...K..e lindur .., e veja ...kalon në posed të 1/2 S.K.,, 1/2 B.K., nga Gjakova, ndërsa parcela nr.5071/32 është vënë në hipotekë sipas Aktvendimeve nr.274/08 të datës 15.07.2008, nr.47/09 të datës 27.05.2009 dhe nr. 3/10 të datës 13.01.2010 në B.E., SH.A.

Baza ligjore

Me nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, është paraparë se *“E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim”*.

Me nenin 46 pika 1 të Ligjit për Familjen i Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm LFK), parashihet se *“Pasuria e cila i ka takuar bashkëshortit në çastin e lidhjes së martesës do të mbetet pasuri e veçantë e tij”*, tutje në pikën 2 të po këtij neni parashihet se *“Pasuri e veçantë është gjithashtu edhe pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së martesës përmes trashëgimit, dhurimit apo ndonjë formë tjetër ligjore të fitimi të pasurisë”*.

Me nenin 47 paragrafi 1 të LFK-së, është paraparë se *“Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me kontribut të përbashkët gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë”*, tutje paragrafi 2 parasheh se *“Kontribut i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës konsiderohet: 2.1. të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort; 2.2. ndihma e bashkëshortit e afruar bashkëshortit tjetër, siç është kujdesi për fëmijët, udhëheqja e punëve të shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët”*, ndërsa paragrafi 3 parasheh se *“Kontributi i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës për fitimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet i barasvlershëm”*, paragrafi 4 parasheh se *“Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët, nëse nuk janë marrë vesh ndryshe”*.

Me 50 paragrafi 1 të LFK-së, është paraparë se *“Të drejtat e bashkëshortëve për sendet e paluajtshme, të cilat janë pasuri e tyre e përbashkët, ashtu siç parashihet në nenin 47 të këtij Ligji, regjistrohen në Regjistrin publik të pasurive të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët në pjesë të papërcaktuara”*, ndërsa pika 2 i këtij neni parasheh se *“Kur vetëm njëri prej bashkëshortëve regjistrohet si bartës i së drejtës pronësore për pasurinë e përbashkët në regjistrin e të drejtave në pasuri të patundshme, do të konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të dy bashkëshortëve. Pasuria nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve, ashtu siç është përcaktuar me ligjin në fuqi”*.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata pas administrimit të provave të lartcekura, dhe me aplikimin e dispozitave ligjore të cekura si me lartë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar, për arsyet si në vijim:

Gjykata në riprocedurë ka vlerësuar pretendimet e paditëses lidhur me pronësinë në paluajtshmerinë e cila është objekt kontesti, përkatësisht lidhur me pretendimin se në bazë të kontributit në martesë është pronare e 1/2 pjesë ideale e paluajtshmërisë e cila evidentohet si njësi kadastrale P-70705029-05071-32 me kulturë shtëpi, në sipërfaqe të përgjithshme 207 m² ZK Gjakovë-qytet, e regjistruar në emër të ish të paditurit - tani të ndjerit I.K., (bashkëshorti i paditëses).

Në këtë drejtim, paditësja me asnjë provë materiale nuk ka arritur që të provoj faktin se paluajtshmeria objekt kontesti ka qenë ndonjëherë e regjistruar në emër të saj apo se kjo pronë është përfituar përgjatë ekzistimit të martesës me këtu të ndjerin I.K.,

Përkundrazi, me historiatin kadastral të siguruar zyrtarisht nga kjo gjykatë, është provuar se prona objekt kontesti, në vitin 1971 ka qenë fillimisht pronë e paraardhëses se të ndjerit Iljaz, përkatësisht në emër të ... K., ku në vitin 1981 në bazë të kontratës se ndarjes me numër leg.nr.1323/81, të datës 15.12.1981, parcela objekt kontesti 5071/32 prej .. K..kalon në pronësi të te ndjerit I.K.,

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e paditëses, se e njëjta ka kontribuar në ekonominë familjare, fakt që edhe për këtë gjykatë është i ditur dhe prezumohet, pasi që kontributi i bashkëshortëve në martesë është obligim ligjor, i cili kontribut përfshin kujdesin për familjen, mirëmbajtjen, apo edhe kontributi përmes formës ekonomike, më punë të secilit bashkëshort.

Mirëpo në drejtim të fitimit të pronësisë në paluajtshmerinë objekt kontesti, pretendimi i paditëses është i pabazuar, për faktin se nga provat e administruara përgjatë këtij shqyrtimi, u provua në mënyrë të padyshimtë se pasuria-prona e paluajtshme 5071/32 objekt kontesti, e po ashtu objekt i kontratës se hipotekës se lidhur në mes të te paditurës se parë dhe ish bashkëshortit të paditëses, nuk është pasuri e fituar gjatë martesës, mirëpo kjo është pasuri e cila kategorizohet në pasurinë e veçantë, i ka takuar të ndjerit I.K., dhe i njëjti ka pasur mundësinë të shfrytëzoj dhe disponoj në mënyrën me absolute të mundshme, sikurse edhe ka vepruar me rastin e nënshkrimit të kontratës me këtu të paditurën e parë, duke lënë hipotekë .

Pra, në këtë rast kjo paluajtshmëri hyn në pasurinë e veçantë të te ndjerit I.K., , ashtu siç edhe është paraparë me nenin 46 në pikën 2 të LFK-së, citoj: *“Pasuri e veçantë është gjithashtu edhe pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së martesës përmes trashëgimit, dhurimit apo ndonjë forme tjetër ligjore të fitimi të pasurisë”*, pra mënyra e fitimit të kësaj paluajtshmërie është përmes kontratës së ndarjes së pasurisë në mes të tani të ndjerit I..dhe familjarëve të tij, e jo më punë të përbashkët të bashkëshortëve gjatë martesës dhe si e tillë nuk hynë në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve siç ka pretenduar paditësja.

Andaj, bazuar në të cekurat si me lartë, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është pa mbështetje ligjore, ngase me rastin e lidhjes se kontratës se hipotekës nga ana e të paditurës se

parë dhe bashkëshortit të saj të ndjerë I.K., , nuk ka qenë i nevojshëm pëlqimi i këtu paditëses, ngase kjo paluajtshmëri kategorizohet si pasuri e veçantë e të ndjerit I...e fituar në vitin 1981 përmes kontratës për ndarjen e pasurisë nga paraardhësja e tij, gjegjësisht nëna e tij... Kusari e lindur Kuqi.

Meqenëse nuk u prova e drejta e paditëses në raport me të drejtën e pronësisë në bazë të kontributit martesor prej 1/2 në paluajtshmerinë 5071/32, gjykata erdhi në përfundim se edhe kërkesëpadia në raport me marrëveshjen hipotekare e lidhur në mes të paditurës B.E, SH.A. Prishtinë dhe të ndjerit I.K., ish nga Gjakova, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë nën Vr.nr.152/2016 të datës 12.01.2016, është e pabazuar, ngase nuk u provua se paluajtshmeria me numër 5071/32, është pasuri e fituar gjatë martesës në mes paditëses dhe bashkëshortit të saj të ndjerë.

Me tutje, kjo gjykatë vlerëson se në këtë rast paditësja duke qenë bashkëshorte e të ndjerit I...K..., nënshkrues i marrëveshjes hipotekare, e që kjo marrëveshje ka siguruar kredinë e ndërmarrjes pronë e djalit të paditëses dhe të ndjerit I.. në një formë ose tjetrën, kredinë dhe frytet eventuale të kësaj kredie i ka shfrytëzuar edhe këtu paditësja duke qenë në bashkësi familjare me të njëjtit dhe se deri në momentin e dërgimit të lëndës në përmbarrim për shkak të vonësive në pagesa, paditësja nuk ka vepruar në drejtim të realizimit të se drejtës se pretenduar.

Gjykata mori parasysh edhe pretendimet tjera ta paraqitura nga palët në procedurë, mirëpo të njëjtat nuk kishin ndikim në vendosjen ndryshe, përpos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së, ashtu që u vendos që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Nga të lartcekurat, e bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1340/21, me 08 shkurt 2024

G J Y Q T A R

Durim BALAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.